

KALIN TERZIYSKI
A KA NJERI QË JU DO?
TREGIME

BOTIMET TOENA

KALIN TERZIYSKI

A KA NJERI QË JU DO?

tregime

Përktheu nga origjinali bullgarisht
Milena Selimi

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2022

Autori: Kalin Terziyski (Kalin Terzijski)

Titulli në origjinal: Има ли кой да ви обича

Botoi në bullgarisht: Janet 45



Me bashkëfinancimin e Programit
“Europa Krijuese” të Komisionit European.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Albina Pulla

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e imazhit në kopertinë: Laurin Sana

ISBN 978-9928-348-87-6

© Kalin Terziyski 2019

© në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

A KA NJERI QË JU DO?

Jashtë bie shi, po ngryset, uji spërkat nga tubat e ballkoneve. Në rrugë dëgjohe zëri i një gruaje që bërtet disi shëmtuar dhe e paqartë. Në verë, mbrëmjeve, zhurma nga rrugët është e veçantë. Asgjë nuk ndodh, vetëm shiu bie dhe freskon ajrin.

Jemi të dy me E.Y.-në. Rrimë në zyrën në të cilën punoj. Nuk di saktë çfarë punoj. Thjesht kam vënë re se nëpër zyra zakonisht sillen njerëz të cilët diçka punojnë. Tek unë nuk është tamam kështu. Unë zakonisht rri, luaj një lojë të vogël elektronike dhe pres që dikush ta mbarojë punën e tij e unë të filloj pas tij. Prandaj ngjaj si pastrueset ose si rojë ndërtimi. Në fakt jam mjek. Të dy me E.Y.-në jemi mjekë. Të dy u neveritëm nga mjekësia pothuajse në të njëjtën kohë. Ka shumë pisllek në mjekësinë e mallkuar bullgare. Tani rrimë në zyrë dhe nuk bëjmë asgjë. Pimë birra. Më mirë se asgjë.

Kur vjen fjala për zyrat, më kujtohen zyrat ku pastrueset e shkollave mbanin kovat, fshesat dhe leckat me të cilat pastronin tualetet.

Ne ulemi dhe pimë birrë, duke folur për gjëra të parëndësishme. Nëse do të mund të flisnim për gjëra rëndësishme, me siguri do të flisnim për to.

E.Y.-ja ecën para-mbrapa dhe troket me gishta në sendet rreth tij:

- Mbrëmë u takuam me Martin K.-në, - tha E.Y.-ja.

Unë kthej karrigen dhe e pyes:

- E, a ishte i dëshpëruar?

- Jo, ishte i dehur... në fakt nga të dy... pak i dëshpëruar dhe shumë i dehur.

Martin K., gazetar i njohur dhe fjalaman i medias, është shoku ynë.

Bashkë kemi bredhur me gra, kemi pirë dhe kemi diskutuar për jetën më shumë se dhjetë vjet.

- Më mori mbrëmë dhe tha se donte të më takonte, - tha E.Y.-ja.

Dje Martin K. më telefanoi edhe mua. Më kërkoi të shkojmë bashkë në aeroport për të përcjellë Lili Marlen Hamër, e Gjata.

Unë e pyeta “Përse?”. Ai më tha: “Më duhesh... dua të bërtasim dhe të këndojmë derisa të niset avioni.”.

“Gjepura, të bërtasim... Jam i lodhur... përse flet marrëzira... shko dhe përcille vetë, për atje... ku do të shkonte ajo... Hajde, *ciao*.”

Disa orë më vonë Martin K. më mori përsëri: “Kam nevojë për ty.” “Jo, jo, jam i lodhur, çfarë bëre, e përcolle atë?” “Po, po, nuk dua të flas fare për këtë, eja, duhet të jetë dikush me mua...” “Pi diçka dhe do të të kalojë...”, - i thashë dhe desh e mbylla telefonin për ta përfunduar atë filmin kot që po shikoja, me të cilin po kaloja mbrëmjen time pa kuptim.

Kurse Martini K. bërtiti keq me zërin e të dehurit: “Pederast i mjerë, i paaftë, budalla, pederast, pederast i mjerë, i shkretë...”. Dhe e mbylli telefonin. Dukej se nuk ishte mirë.

Duhet të të tregoj kush është Lili Marlen Hamër, e Gjata. U njoha me të gati para dhjetë vitesh, në det, ishte vajzë e vogël.

Ajo tani është grua e bukur, e gjatë me një bukuri egjiptiane. Ka një shenjë të veçantë në buzën e sipërme, dhëmbë të bardhë dhe flokë të zinj. Një krijesë gjithë dritë dhe e mirë. Është pak mendjemadhe, aq sa duhet, për t’u dalluar se nuk është fëlliqësirë e rëndomtë nga Ljulini; punonte në një video-studio.

Jeton në SHBA me njëfarë italiani. Punon në Bankën Botërore. Unë nuk kam ide fare ç’do të thotë “Bankë

Botërore”, por ç’më duhet t’i di të gjitha vendet e mrekullueshme, të ligjshme për grabitjen e njerëzve?

Fakti që tani ajo jeton me një italian që në fillim m’u duk pervers. Më shkakton thartira në stomak. Vetë fjala italian krijon tek unë asociacionin me ngacmimet homoseksuale në tualetet e burrave, ngrënien e bretkosave dhe makaronave. Ndoshta kam parë filma të papërshtatshëm.

Lili Marlen, e Gjata, erdhi në Bullgari pas një mungese pesëvjeçare dhe menjëherë kërkoi Martin K.-në. Nuk e di nëse ajo ishte veçanërisht e interesuar për të më parë. Nuk arrij ta kuptoj fare sesi Martin K.-ja arrin të tërheqë femrat. Ai i hipnotizon si një piton. Ato janë brejtës dhe ai është piton.

Ajo i ka telefonuar që nga aeroporti, ishin takuar para se ajo të takonte prindërit e saj.

Për disa javë, Martin K.-ja ecte me nerva parambrapa si zog, duke u treguar të gjithëve, i emocionuar, sesa pompa të mira bënte ajo, se si bërtiste në anglisht ndërsa i bënte. Anglishtja e saj e Bankës Botërore, e veçantë për të bërtitur gjatë bërjes së pompave. Si dhe sa shumë e dashka për këtë që bërtet në anglisht, dhe për gjithçka tjetër. Se si do që të martohet me të, si është truproja e saj, shërbëtori, zhigoloja, si do t’ia rregullojë qejfin italianit dhe të gjithë italianëve. Ai thoshte gjëra të tilla sikur të ishte vërtet i dashuruar. E çonte nëpër

restorante, shpenzonte para, dehej dhe i bënte propozime për martesë. Një javë më vonë, ajo shkoi në spital për të vendosur një protezë në arterien e saj renale. Në Bullgari është lirë, dhe italianit i ndyrë nuk mund ta fuste dorën në xhep për një gjë të tillë në SHBA, eh, po!

Pastaj Martin K.-ja i bëri serenadë. I këndoi këngë të kota nën dritaren e dhomës së saj të spitalit. Ajo mbase e do vërtet, thashë me vete atë mbrëmje të serenadës së tij. Mbase dhe ai e do atë.

Më pas, në fakt dje, ajo u nis për në Amerikë për të bërë titull në anglisht, ndërsa i bënte pompa italianit dorështrënguar. Dhe gjithashtu për t'u siguruar se mos Banka Botërore harronte rastësisht të grabiste dikë.

Tani Martin K.-ja është ulur diku dhe po dehet i vetëm, nga boshllëku dhe pikëllimi. I kam të njohura këto gjëra.

Para pesë vjetësh apo ndoshta shtatë, ne, miqtë e vjetër, po kështu rrinim, pinim birra dhe flisnim të njëjtat gjëra si tani. Për dashurinë e femrat, për femrat e pompat që bëjnë ato. Jeta jonë kalon me të folura për të njëjtat gjëra. Një brez i çuditshëm dembelësh, të cilët nuk duan të bëjnë asgjë të rëndësishme në jetën e tyre. Por ndoshta jam gabim, ka kaq shumë burra dhe gra tridhjetëvjeçarë që merren me punëra si *piar*, menaxherë dhe të tjerë pisa të ngjashëm, të cilët janë të veshur elegantë dhe punojnë nga njëzet e katër orë. Për shembull në Bankën

Botërore... Me siguri këta janë njerëzit e vërtetë të këtij brezi. Ne, miqtë e vjetër, nuk ua kemi zili. Nëse u kemi zili për ndonjë gjë, kjo është për besimin e madh të tyre, që nesër përsëri do të çohen dhe do të punojnë njëzetë e më shumë orë dhe për besimin e tyre dhe më të madh se e gjitha kjo i bën ata diçka më shumë se bythëmëdhenj të zakonshëm.

Ulemi dhe flasim, shiu po bie, ajri po freskohet... Ndihem i tensionuar; ndonjëherë dhe bukëshkelësit thekur ndiejnë siklet - kjo fjalë turke për pendim të ethshëm, e ka burimin te dembelizmi i pakuptimtë. Ulem para kompjuterit dhe po i propozoj E.Y.-së:

- A fillojmë dhe shkruajmë ndonjë gjë...

E.Y.-ja më shikon me sytë e tij të vegjël mongoloidë dhe fillon të më diktojë duke u tallur me një zë melodioz: "... dhe Ana Karenina ka thënë: Allaballa portokalla, hajde Vanço jep pesë para...".

Unë: Duhet të shkruajmë... ndryshe përse jemi këtu?

E.Y.-ja sillet nëpër zyrë, troket ca takte muzikore dhe godet me shkelm karriget:

- E po, nuk di fare... përse jemi këtu. Unë nuk di fare përse jam akoma gjallë...

Ne me E.Y.-në, si dhe me Martin K.-në merremi me shkrime. Kjo është një mënyrë e mirë të justifikosh dembelizmin tënd, të tregohesh interesant për gratë, të

shpjegosh gjendjen kronike gjysmë esëll dhe të fitosh para, që të sigurohesh.

Martin K.-ja e ka marrë seriozisht punën e të shkruarit, ne jo dhe aq. Ai i merr punët seriozisht, pi seriozisht dhe fle seriozisht me të gjitha gratë, të cilat kalojnë në një rreze prej njëqind metrash prej tij. Tani vuan seriozisht.

Duhet të shkruajmë. Nuk mund të rrihet kështu kot.

Qëkur i madhi Douglas Adams përdori një kompjuter me një redaktues teksti për të shkruar gjërat e tij, shkrimi është bërë punë e gjysmë-teknokratëve. Font, insert, format, andu, bla-bla etj. Por ne jemi gjysmë teknokratë, neve nuk na pëlqen të shkruajmë. Prandaj merremi me shkrime. Në kohën tonë askujt nuk i vjen të shkruajë, askujt nuk i punohet. Është e trishtueshme se nuk ka për çfarë. Ku është ai vetëbesim i mrekullueshëm i luanëve të rinj, të cilët punojnë dymbëdhjetë orë në ditë? Besimi i tyre, se kur të zgjohen nesër, portat e parajsës do të jenë të hapura për *yuppie*-t, ku ata do të kenë mundësi pune tetëmbëdhjetë orë në ditë. E shkruara është punë e njerëzve të vetëmjaftueshëm, që jetojnë nëpër shpella, hanë myshk dhe shkojnë në konferenca botërore një herë në muaj për të luftuar SIDA-n ose diçka tjetër.

Unë shikoj dyshtemenë, pi një gllënjë birrë dhe i them E.Y.-së:

- Dhe çfarë do që të bësh ti, pederast i pakënaqur, kur s'passe qejf të shkruash? Pse s'do të shkruash?

- Unë nuk dua të shkruaj. I kam qejf femrat. Më pëlqen të shkoj me femra. Unë nuk jam shkrimtar, jam i dhënë pas femrave.

Në realitet nuk është kështu. E.Y.-ja ka një qasje tjetër ndaj femrave. Në fakt të gjithë ne, poetë të paudhë, kemi një qasje të veçantë ndaj femrave. Për shembull, kur lexoj diku "... ata u hodhën njëri mbi tjetrin dhe filluan një seks të egër, të papërmbajtur, seks shtazor", bëhem keq. Më merret fryma, gati lodhem. Dhe them me vete, përse njerëzit po civilizohen prej dhjetëra mijëra vjetësh, që pastaj t'u gëzohen gjërave të egra dhe shtazore? A nuk është më mirë njeriu të shtrihet pa lëvizur në shtratin e tij të ftohtë, ndërkohë që femra e qetë dhe e urtë t'ia thithë penisin në heshtje dhe e thelluar? - kështu mendoj unë, kështu mendon dhe E.Y.-ja. Seksi i egër, agresiv, shpërthyes është shpikur për relaksim pas pune të njerëzve mendjeshëndoshë dhe të punës. Ai i forcon arteriet. Këta lloj pisash mendjekthjellët, biznesmenë, seksin e bëjnë njësoj si bëjnë çdo gjë tjetër. Ata i bëjnë të gjitha. Bëjnë seks, bëjnë kalamaj, bëjnë para, bëjnë dashuri, jo dhe luftë, por kur është e nevojshme bëjnë dhe luftë. Ata pinë lëngje, pije të freskëta, lëngje frutash, vrapojnë, merren me ngritje peshash, me not, me *serf*, me sport, kanë vetura të shtrenjta, flasin për to, kanë nga tre fëmijë, kanë synime, objektiva, ua qijnë robt të gjithëve, presin t'i falënderojnë për këtë etj.

Ne me E.Y.-në i shohim gjërat ndryshe.

E.Y.: “Unë nuk dua seks, kam dëshirë të shkoj diku me miq dhe me gra... thjesht për kënaqësi... diku, vetëm ashtu, në liri.”.

E.Y.-së gjithmonë i ka pëlqyer të bisedojë me shokët dhe femrat ta dëgjojnë. Çdo mashkulli i pëlqen të bisedojë me shokë për artin, për makina, kazerma dhe femra, dhe, femra të tjera ta dëgjojnë.

Mua më pëlqejnë idetë e E.Y.-së për jetën, i vlerësoj, janë të ngjashme me të miat.

E.Y.: “... femrat janë vetëm për luks...”.

“A thua vërtet femrat janë për luks?” - them unë me vete.

Mendja më shkon te Lili Marlen, e Gjata. Ajo po, është femër luksi. Ajo nuk do të të ndihmojë të pastrosh bodrumin. Nuk do të nxjerrë kutitë me lesh dhe kakërdhi miu nga bodrumi yt i papastruar. Nuk do të marrë pjesë në pastrimin e shpirtit tënd.

Çfarë bën Martin K.-ja? Me siguri provon të bëjë diçka për të larguar vetminë dhe zbrazëtinë. Pi apo punon?

Mbase shikon programe për kafshë. Kam vënë re se njeriu ka filluar të shikojë shumë emisione për kafshë kur ndien zbrazëti dhe vetmi.

Ta kërkojmë, apo jo? Por kur njeriu është keq, më mirë mos e kërko. Vetëm do ta rëndosh duke u përpjekur ta mbajë veten normal. Apo jo?

E.Y. -ja pështyn nga dritarja dhe sikur e kapi mendimin tim për Martin K.-në.

- E di, dje, babai... atij i pëlqen të lexojë në tualet, të gjithë librat që ka lexuar vitet e fundit atje i ka lexuar... pra babai hyri në tualet me “Deflorimi”-n...

“Deflorimi” është libri i parë i Martin K.-së, një libër i hollë me poezi. Disa nga poezitë janë të mira, të tjerat naive, por në tërësi është i mirë. Shumica e poezive janë të pista.

E.Y.-ja vazhdon të më tregojë:

- Babai mbeti më shumë se një orë në tualet dhe lexoi “Deflorimi”-n e Martin K.-së. Kur doli pyeti: kush i ka shkruar këto fëlliqësira? Babi, jo nuk jam unë, i thashë. Dhe u frikësova se nuk do të ma lërë mua apartamentin e tij, për shkak të vjershave të ndyra të Martin K.-së.

“Ja, pra, - them me vete, - si i shijojnë të rriturit luftërat dhe funeralet, terapitë me rreze dhe vrimën e ozonit... Kur bëhet fjalë për organet e burrit dhe gruas që krijojnë fëmijët e vegjël, ata menjëherë fillojnë të vjellin, të pështyjnë në mënyrë hipokrite. Në fakt edhe unë jam njeri i rritur. Kam fëmijë të rritur. Mbase ashtu shkojnë gjërat, - mendoj unë. - Askujt nuk i shkon mendja se një ditë fëmija e tij do të bëjë seks.”

Martin K.-ja drejton një emision në Darik Radio. Shumë i mprehtë, shumë i zgjuar - të paktën kështu thonë gratë që bëjnë seks me të. Në fakt edhe unë kështu

mendoj. Emisioni i tij është pikërisht sonte. Pas disa orësh do të jetë në transmetim.

- E di çfarë teme ka sonte Martini? - pyet E.Y.-ja.

Ai u troket tasteve të kompjuterit pa ndonjë qëllim.

- A ka njeri që ju do?

- Është tema e tij, - më thotë E.Y.-ja.

Ai do që ta thërrasim me zëra të maskuar, si njerëz të ndryshëm, çdo pesë minuta dhe t'i themi: "Ty nuk ka kush të të dojë, o budalla i trashë.". Ose të shtiremi si italianë dhe t'i themi: "Buongiorno, signor Martini... mos keni palluar rastësisht të dashurën time?".

- A nuk është e poshtër kjo?

- Absolutisht, jo, - përgjigjet E.Y.-ja.

Në fakt temë interesante. "A ka njeri që ju do?" Mami, babi, gruaja, e cila është pranë jush, gruaja e rastit, me të cilën flini, miqtë, fëmijët tuaj, ose një Zot e di edhe kush tjetër... vërtet, a ka kush t'ju dojë? Më ka ndodhur të mendoj për këtë dhe kur mendoj mjaft gjatë shpërthej në lot.

- E pse mos e marrim Martinin K.-në dhe t'i themi emrat e gjithë atyre që e duan? - pyes unë E.Y.-në.

- E pse ta gënjejmë njeriun e shkretë? Nëse ty të merr dikush e të thotë diçka të tillë, a do ta besosh?

E.Y.-ja ka të drejtë. Besojmë shumë lehtë kur na thonë se na urrejnë, besojmë shumë vështirë kur na thonë se na duan. Nuk u besoj femrave kur thonë se më duan. Më

parë më pëlqente t'u besoja, por tani e di se kur janë të reja thjesht flasin budallallëqe, se u flasin hormonet. Kur shkojnë vitet thonë se na duan nga frika dhe nga vetmia. Kam frikë se as fëmija im s'më do... Edhe kur e thotë, dyshoj se e thotë për të marrë atë që kërkon. Oh, sa keq!

Çfarë po bën Martin K.-ja ndërsa po përgatitet për emisionin me temën "A ka njeri që ju do?"

Ndërsa ishte duke ikur, na tregoi E.Y.-ja, Lili Marlen, e Gjata, çfarë s'i kishte thënë Martin K.-së. I pat thënë se, në fakt ajo është fatkeqe në Amerikë, e vetmuar, shumë e vetmuar, që s'mund të dashurojë askënd tjetër, por i duhet të kthehet në Amerikë, sepse jeta është e poshtër dhe asgjë s'varet nga ne. Oh, jeta është e poshtër, asgjë s'varet prej nesh. I pat thënë se do të mendonte vazhdimisht për të. Ai e ka pyetur: "Edhe kur të pallohesh me italianin?". Ajo është trembur nga vrazhdësia e fjalëve dhe ka qarë. "Madje edhe atëherë."

Pas kësaj Martin K.-ja është ndarë dhe është larguar duke u përpjekur të duket si një burrë i fortë, se mos i shpëton ndonjë lot nga bishti i syrit dhe t'i shkaktojë korezion burrërisë së vet. Një Heminguej, që s'i bëhet vonë nga ndarjet me dashnoret e panumërta. Por unë di se nuk e ka pasur të lehtë. Me vete ka thënë: "Ajo ma hodhi, ajo ma hodhi, e, në fakt, s'ishte i zemëruar, ka ndier veç zbrazëtim dhe trishtim."

Jashtë dhe për pak shiu po pushon. Është errësuar. Një natë vere tashmë e lagësht. Në rrugë, një grua bërtet diçka të pakuptueshme e të shëmtuar. Në kohë vere zhurma e rrugëve natën është shqetësuese. Asgjë s'po ndodh, shiu ka pushuar pa freskuar ajrin.

Jemi të dy me E.Y.-në në zyrën ku punoj unë. Në fakt s'punoj asgjë. Kë gënjej. Rrimë dhe flasim për këtë, kush e do Martin K.-në. Me siguri secili prej nesh mendon kush e do atë vetë. Por jemi kaq të ngathët, kaq të pandjeshëm, kaq të mbrojtur nga trishtimi përmes mërzisë, sa faktikisht s'ndiejmë asgjë gjatë kohës që bisedojmë.

Hap radion, që të dëgjojmë emisionin e Martin K.-së me temën "A ka njeri që ju do?". Kalon sinjali i fillimit, zëri i tij i sigurt - jo dhe aq sa zakonisht - thotë:

- Përshëndetje, sofjanas të natës, jeni me programin e natës të Radio Darik. Unë jam Martin K. Sot do të flasim për diçka të pazakonshme. Ndoshta jeni mësuar, ndoshta edhe unë u mësova të flas për prostituta, martesë homoseksuale dhe sëmundje të rralla veneriane. Me siguri edhe sonte prisni që të flas për droga të buta dhe të forta dhe t'ju bëj pyetjen: "Kur keni bërë seks anal për herë të parë?", por sonte kam vendosur, ndoshta për arsye krejtësisht personale, të flas me ju për temën... Dëgjoni temën e kësaj mbrëmjeje: "A ka njeri që ju do?". E pazakonshme kjo temë... Shihni tani... Unë sonte kam vendosur të bëj diçka ndryshe. Nuk do të bëj pyetje,

thjesht do të lë telefonin hapur dhe secili mund të flasë. Paralajmëroj regjisoren e pultit, thjesht i lutem ta bëjë këtë - të transmetojë thirrjet drejtpërdrejt në emision, pavarësisht nga unë... në fakt kjo s'ka si të bëhet... unë s'do të flas në këtë emision... thjesht secili do të rrëfejë në eter, a ka njeri që e do. Ju lutem, bëjeni këtë për mua, thoni kush ju do... Pra, për tani, mirë u dëgjofshim... Telefononi në linjat e studios dhe flisni... flisni qartë dhe saktë - kush ju do... Hajde.

Pas kësaj nga aparati i radios dëgjohet një zhurmë e fortë si e shtënë pistolete. Nuk dëgjohet asgjë për pesë minuta transmetim. Pastaj hyn dëgjuesi i parë që do t'u thotë dëgjuesve se kush e do.

Ne me E.Y.-në qëndrojmë dhe s'dimë ç'të bëjmë.

MBLEDHËSI I VLERA VE

Mbledhësi i vlerave nxjerr nga xhepi i pantallonave të tij një paketë cigaresh të zhubrosur, një nga vlerat që zotëron - dhe ndez cigaren. E ndez me një çakmak ku shihet fotoja e gruas lakuriq, e zbehtë nga përdorimi - gjithashtu vlerë.

Tërheq hundët, pështyn dhe shtyn karrocën gjysmë të mbushur me vlera. Ecën ngadalë në rrugë. Ndërtesat, e rreshtuara në anë, janë gri të errëta, sepse rruga është e vjetër. Mbledhësi ngjan si i hutuar, por kjo prej tymit të cigares, ka picërruar sytë, por e sheh me kujdes tokën përpara këmbëve, asgjë s'i shpëton. Ja - shikimi i tij bie mbi një send, që mund të jetë interesant - një copë letre paksa e zverdhur - përkulet dhe nxjerr një faqe gazete, e futur mes koshit të plehrave dhe kioskës së braktisur të gazetave, atje ku është zverdhur përgjatë një viti.

Po, data është fiks e njëjta, por para një viti. Në faqen e gazetës ka një titull: “Gjatë muajit mars bricjapi do të ketë sukses në biznes, dashi në dashuri”. Në faqen e pasme ka nekrologji dhe një nga fotografitë është e një gruaje të re, me sy të zgjuar”, vlerë, mendon mbledhësi dhe e fut faqen e gazetës mes vlerash të tjera në karrocën e tij. Bën përpara, i frymëzuar nga bollëku i vlerave që i ofrojnë rrugët, trotuaret, kazanët e plehrave, Bota. Gjen një këmbë të kukullës Barbi, një shishe bosh parfumi, e cila ka akoma aromë, një stilolaps pa bojë, një syth karafili të freskët, një pendë laraske, gjysmën e dytë të novelës “Sonata e Krojcerit” të Leon Tolstoit, një lugë çaji, një pjesë të një aparati elektronik. I vendos të gjitha në vendin e përshtatshëm në karrocë, që ta ketë më të lehtë gjetjen pastaj. Është i kënaqur nga sendet e gjetura dhe i shkujdesur sheh tokën para vetes, më shumë për kënaqësi - tashmë ka mbledhur mjaft vlera për këtë ditë. Kthehet në shtëpi, ngre karrocën me kujdes deri në katin e dytë, hap derën dhe hyn në mbretërinë e tij të vlerave. Për çdo njeri tjetër ajo mund të ishte një vrimë e neveritshme, vend plehrash, tmerrësisht e mbushur me plehra të neveritshme, por për mbledhësin e vlerave ky është vendi më përrallor në botë. Ai ka mbledhur mbetje të lumturisë njerëzore, trishtim, kënaqësi, punë, dëshpërim, gjenialitet, frikë, budallallëk, dehje dhe çmenduri. Mbledhësi i vlerave sheh i kënaqur mbretërinë

e tij, i rregullon një orë të tërë sendet e sapozbuluara, pastaj ulet në dysHEME, ndez cigaren dhe nis të lexojë një nga letrat e dashurisë, gjetur para dhjetë ditësh, të lidhura fort në një pako dhe hedhur në shkurret e një kanali. Letra fillon kështu: *“I dashuri, i dashuri, i dashuri im, prej tri ditësh nuk të kam prekur, nuk të kam puthur, nuk kam dëgjuar zërin tënd dhe s’kam ledhatuar flokët e tu. Më mungon kaq shumë sa ndiej një dhimbje fizike, njësoj sikur më është shkukur një organ me rëndësi jetike. Aq sa edhe ajri që thith pa ty s’ka shije, nuk më mjafton dhe mushkëritë i kam bosh. E gjithë bota është bosh pa ty...”*.

“Vlerë”, mendon mbledhësi i vlerave dhe ndez cigaren tjetër, duke vendosur cigaren e porsafikur në vendin e përshtatshëm.

LYPËSI

Ndërsa ecim me vajzën time në rrugën “Ivan Asen” shoh shtëpitë. Shtëpitë në Sofje janë të shëmtuara, sepse janë të vjetra dhe e vjetra nuk i fisnikëron, por vetëm shkatërrojnë suvanë e tyre.

Po shoh dhe nja dy gra, por gratë janë me supe të ngushta dhe vithe të gjera. Seksualisht tërheqëse. Sikur menjëherë duan diçka të keqe - të gjejnë një burrë të pasur, të martohen, të lindin fëmijë të gjinisë mashkullore, që të bëhen pastaj ushtarë të mirë dhe të vrasin ndonjë njeri të pafajshëm, kur të jetë duke ngrënë drekë.

Prandaj po eci dhe shoh gjithçka, njësoj sikur asgjë. Kjo s’arrihet lehtë, por gjithkush e bën përditë në mënyrë të pandërgjegjshme.

- Ndoshta do picë?

- Hmmm, po..., - përgjigjet me zë të zvarritur vajza ime.

Më ngre nervat kur sheh anash, e përhumur në një trans të saj vajzëror. Kot më kot. Edhe unë ashtu jam. Ajo sheh gjithçka njësoj sikur asgjë.

- Do ta hash, apo jo? - pyes unë duke e tërhequr për dore.

- Hmmm, po, - dhe sërish sheh në hapësirën e padukshme, e mbartur.

E njoh këtë gjendje. Kur s'mendon, s'ndien dhe s'dëgjon. Je vetëm i gjallë. Diçka si nirvana fëmijërore, lehtësisht e arritshme.

Ecim drejt pavijonit ku shesin pica, unë bëj kujdes se kalojnë makina, vajza ime ka lënë dorën e saj në timen dhe ngatërrohet në këmbët e mia, sepse nuk sheh ku shkel.

Ndërsa kujdesem mos na shtyp ndonjë makinë, mendoj për fëmijërinë. A jam ndier mirë në fëmijërinë time? Në përgjithësi, a kam ndier gjë? A kam ndier vazhdimisht këtë përzjerje të ndjenjës së fajit dhe të acarimit nga detyrimet e vazhdueshme? Natyrisht që jo. Por, qëkur jam rritur, i ndiej gjithmonë këto gjëra. Si fëmijë me siguri kam ndier ca budallallëqe fëmijërore.

Vajza ime përmendet dhe më tërheq se pranë saj kalon një qen. Tani paskam qenë unë i mbartur.

- Ku sheh... gjoja je i rritur, - më tërheq dorën ajo.

Po, i rritur jam, sa e trishtuar është kjo. Më duket se më e trishtuar ishte kur isha fëmijë. Atëherë kuptoja qartë, fare qartë se jam i varur nga çdo gjë dhe nga të gjithë dhe se të gjitha kënaqësitë e vërteta janë të fshehura nga unë. Në dollapin e rrobave, me çelës nga nëna ime e rreptë. Njëherë gjeta çelësin e këtij dollapi, e gjeta afër disa shisheve shampanje, të cilësisë së dobët, të pahapura, të mbetura nga festat familjare të pakuptimta të Vitit të Ri, atje, mes rrobash të palosura dhe me naftalinë gjeta tamponë grash. Isha njëkohësisht edhe i stresuar, edhe i ekzaltuar nga zbulimi im. Sa e pështirë dhe tërheqëse është kjo që fshehin nga unë. Nuk kuptoja saktësisht se çfarë përfaqësonin këta cilindra të vegjël, por me intuitë ndjeva se hynin diku, dhe kjo “diku” është tempulli i kultit tim të fshehtë të turpit.

Mendoj se, që të shpëtoj nga fëmijëria, u rrita.

- Tatesh... (kushedi nga ma shpiku këtë emër hungarez).

Arritëm. Çfarë po mendon?

- Asgjë, babi mendon budallallëqe.

Hymë në restorantin e vogël dhe unë, pa interes, shoh copat e picave të ekspozuara - të holla dhe pa shije - një tentativë e dobët për të tërhequr klientë të uritur. Vajza ime i pëlqen, sepse kanë misër. E nga doli ky misri kështu? Mos vallë duan të na mësojnë të hamë ushqim foragjer? Mes të tjerash ushqimi i vërtetë në botë po pakësohet.

Tashmë fëmijët e vegjël po mësohen me misrin. Si dhe gratë budallaçka, që mendojnë se do të shpëtojnë nga celuliti dhe burrat më të pasur e të bukur do të dashurohen me to.

- Një copë picë me misër, - më tërheq dorën vajza.

- Një copë picë me misër, - përsëris unë dhe jap paratë.

Ndihem i dobët dhe i pakënaqur, se s'kam ndikim mbi vajzën time. Nuk mund ta mësoj me atë që konsideroj të mirë. Ajo është shtatë vjeçe dhe tani di gjithçka më mirë se unë. Është gati të debatojë. Unë s'kam energji të bëj debat. Veç kësaj do të ishte qesharake, një burrë i rritur dhe një fëmijë i vogël të debatojnë në rrugë. Unë dua që ajo të mos hajë *McDonald's* dhe misër. Dua që ajo të ketë një qasje estetike ndaj ushqimit.

Dua të ketë interes më të madh ndaj së kaluarës dhe gjërave të vërteta (ato që unë konsideroj se janë të vërteta) - më duket se fëmijët e sotëm nuk interesohen për të kaluarën deri në atë shkallë sa që ajo pushon së ekzistuari.

Dua të kem pushtet mbi këtë njeri të vogël - një pushtet të mirë dhe fisnik, që t'i mësoj gjëra të mira. Por, nuk kam.

Dhe çfarë gjëra të mira do t'i kisha mësuar? Po të ishte djalë, pas disa vitesh do ta kisha mësuar të rruhet.

Ajo e merr picën dhe nis të hajë. Ha sikur po përpin diçka të papërshtatshme për ngrënie. S'duket se i shijon.

Unë jam llupës. Më duket se brezat e rinj as që kanë për ta kuptuar thelbin e fjalës “llupës”. Ata do të hanë alga dhe mbeturina të ricikluara për të mos pasur atë gjënë e mërzitshme, si i thoshin - ah, po, uri.

Dhe kur ajo ha aq sa mban barku i saj i vockël, ndërkohë që koret dhe copat e forta të djegura të brumit i ha unë (sepse jam i mirë dhe i gatshëm për sakrificë), ikim duke fshirë buzët me peceta letre.

Unë duke menduar, ajo udhëheq. Mendoj për ushqimin. Ushqimi është kënaqësi që, kur të vijë koha të jetë i pamjaftueshëm, do të bëhet diçka edhe më e turpshme se seksi. Po, po! Mos hani gjalpë - ka kolesterol... si dhe mishi. Buka është ajo që na vret. Alkooli na bën të shëndoshë dhe të trashë. Në fund, gjithashtu na vret. Vera - gjaku i Krishtit - na vret. Eh.

-Ty të pëlqen Shakira? - pyet vajza ime.

- Po, shumë...

- Edhe mua, vetëm se... jo dhe aq shumë.

- Pse?

- Sepse më pëlqen Pink...

- Dhe mua më pëlqen shumë.

Mendoj për “Beatles”-at. Ata më pëlqenin shumë dikur. Edhe tani. Si çdo budallai që po plakët. Pse më pëlqejnë? Me siguri sepse prindërit e mi nuk i pëlqenin.

Sa e mërzitshme. Dhe, pse jo? Sepse janë të mëdhenj dhe të talentuar? Jo, thjesht sepse prindërit e mi nuk i pëlqenin, ata s'pëlqenin asnjë lloj muzike. Ata pëlqenin këngët e Lili Ivanovës, pëlqenin të tregonin thashetheme për të dhe të diskutonin hollësisë nga jeta e saj private, e cila me siguri ishte po aq idiote sa jeta e tyre.

Na del përpara një lypës trupmadh, gati sa unë. Më i shëndoshë. Burrë i moshuar. Rreth të 60-ave. Me uniformën e fatorinos, por e ndryshuar aq sa të duket e një lypësi.

Mban një torbë në krahë, po kaq butaforike sa që më acaron nervat. Njësoj sikur kërkon të vërtetojë se është lypës, se në torbën e tij ka copëza buke të ndenjtur, me të cilat do të ushqejë fëmijët e tij të uritur.

- Zotëri, nuk jam lypës. Nuk kam para për t'u kthyer. Jam nga rrethi i Plevenit. Po bëj kryqin. Askujt tjetër nuk do t'i kërkoj, por ti je njeri i mirë. Më duhen për trenin. S'jam lypës dhe s'do kërkoj gjetikë. Më duhen për trenin. Më jep tri leva që të kthehem. Zoti të dhëntë shëndet. Robt ku t'i kenë lypësit e pisët. Unë i dua për trenin, që të kthehem. Më presin atje. Nipçet... E paç me shëndet gocën. Më jep tri leva.

Dhe unë dua t'i tregoj vajzës sime ç'është mëshira.

Mendoj... Ja, ai është i pështirë. Ngjan si mashtrues, por ajo, vogëlushe dhe e paditur, do ta shohë se njeriu i

mirë nuk interesohet kujt dhe çfarë i jep. Do të mësojë se rëndësi ka mëshira dhe dhembshuria.

Por shoh se lypësi ka një dhëmb floriri në gojë, gjë që po më çmend dhe i them vetes: Qetësohu dhe mos gjyko njerëzit nga dhëmbët e tyre prej floriri!

Vajza e vogël le të shohë si jepet mëshira dhe si bëhet një e mirë.

Nxjerr katër leva nga xhepi - një dyshe dhe dy njëshe. Numëroj tri leva dhe zgjas dorën t'ia jap. Ai i merr shpejt me shkathtësi e vrazhdësi, duke tërhequr edhe njëshen.

- Të ha diçka, s'kam ngrënë gjithë ditën.

“Edhe më mirë”, mendoj unë, por vajza më sheh pak si e trembur.

- Përse i jep para? Ai është jevg.

- Si? E çfarë pastaj... A është njeri dhe ka nevojë... A nuk kuptove se s'ka para të kthehet në shtëpi dhe s'ka ngrënë. Nuk ka rëndësi se kujt i jep, rëndësi ka, se kur i jep tjetrit... bëhesh më i mirë.

Vazhdoj t'i flas gjëra edhe pesë minuta të tjera, të cilat vetë i besoj me vështirësi, por kam shumë dëshirë që ajo të besojë.

Ndërkohë në kokën time, në zemrën time lind një zemërim - zemërimi i njeriut të gënjyer.

Qëndroj në qoshen e rrugës, ndjek lypësin, çfarë do të bëjë ai tani që ka katër levat e mia. Vajza ime e shqetësuar